

thënë Elezi. Debatu rreth kësaj pike të rendit të ditës ka vazhduar me kritika të ashpra në mes vetë deputetëve, ndërsa Nexhmedin Balaj nga AKR-ja, akuzoi PDK-në, se si parti është duke shfrytëzuar mandatin për dhënie me koncesion të të gjitha pasurive të komunës.

Bilalli (LDD). Pas kërkesës së deputetit Elezi, propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit afarist-banesor është shtyrë për miratim për seancën e radhës. Në këtë seancë këshilltarët kanë miratuar një vendim për krijimin e

këshilltarët komunalë vendosen për dhënie të 20 banesave në objektin e ndërtuar me koncesion, 9 për administratën komunale, 8 këshilltarëve komunalë dhe 3 shoqatave të luftës. Në këtë mbledhje, këshilltarët kanë votuar edhe një vendim për ndërrim të pronës komunale me ndërmarrjen e "Ferronikelit".

Krijimi i deponive të mbeturinave në Lipjan pa kundërreagim

Shoqëria civile akuzon Inspektorinë komunale për mosveprim

"Drejtorja e Inspektoratit komunal nuk ka pasur efikasitet në parandalimin e këtyre dukurive dhe është bashkëfajtoare në krijimin e një gjendjeje të tillë", ka thënë Krasniqi nga YAHR-i

KOHA Ditore

ARIAN DURIQI

LIPJAN, 28 PRILL- Krijimi i deponive të mbeturinave vend e pa vend dhe mungesa e veprimit të organeve përkatëse rreth këtyre dukurive negative ka nxitur reagime të organizatave joqeveritare në Lipjan. Shoqëria civile ka akuzuar, të enjten, udhëheqës të Inspektorisë në Lipjan se po shfaqen neglizhues krahas krijimit të deponive të egra. Disa mbeturina ndërtimore që janë hedhur pa asnjë kujdes ditëve fundit, e që janë parë në hyrje të Lipjanit afër lumit Sitnica, kanë shtyrë shoqërinë civile të reagojë ashpër me këtë rast. "Organizata Joqeveritare YAHR reagon ashpër dhe shpreh shqetësimin e qytetarëve të Lipjanit ndaj shëmtimit të pamjes në hyrje të qytetit të Lipjanit të ura mbi lumin Sitnica, sepse persona e papërgjegjshëm me hedhjen e mbeturinave të ngurta ndërtimore kanë krijuar një deponi të egër të mbetjeve, me një pamje të vrazhdë jonjerëzore para hyrjes së qytetit të Lipjanit", ka thënë Bekim Krasniqi, udhëheqës i organizatës së të rinjve YAHR. Sipas tij, me këtë rast jo vetëm që është shkakuar pamje e vrazhdët, por është bërë edhe ndotja ambientit nga materiet e ndryshme kimike të hedhura në këtë vend, fare afër lumit Sitnica. Për këtë gjë ai fajëson Inspektorinë e Lipjanit. "Po



ashtu organizata jonë reagon ashpër ndaj Drejtorisë së Inspektorisë, që nuk kanë qenë efikase në parandalimin e këtyre dukurive, ndërsa është bashkëfajtoare në krijimin e një gjendjeje të tillë", ka thënë Krasniqi, ndërsa ka kërkuar nga ekzekutivi i Komunës së Lipjanit, përkatësisht nga kryetari i Komunës së Lipjanit që me autoritetin e vet të intervenojë dhe të parandalojë këto dukuri negative. "Duhet të intervenohet që Lipjani ta kthejë pamjen e bukur e cila ka qenë në hyrje", ka shtuar ai. Ndërkohë që, Bajram Rizani, drejtor në Drejtorinë e Inspektorisë në Lipjan, ka deklaruar se ky dikaster

ka herë ka filluar aplikimin e gjobave lidhur me hedhjen e mbeturinave në vende të palejuara e që sipas tij nuk janë në një numër të vogël, ndërsa premtion angazhim shtesë të inspektorëve që menaxhon rreth rastit në fjalë. "Krijimi i deponive të egra është një telash që po na përcjell vazhdimisht, por siguroj se ka angazhim shtesë të inspektorëve dhe po shpërndajmë fletëparaqitje për të gjithë ata që po tregohen të pasjellshëm në hedhje mbeturinash. Inspektorët janë në përpjekje për të identifikuar ata që krijuan edhe deponinë për të cilën po flitet dhe sigurisht se do të reagojmë", ka thënë ai.